



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel/Fax 04 2226814; 22268142

Nr. 1649 Prot.

Tiranë, më 27.09.2017

V E N D I M

Nr.198, datë 27/09/2017

"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 42, datë 28.02.2017, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Drejtoria e Bujqësisë Lezhë"

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 42, datë 28.02.2017, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Drejtoria e Bujqësisë Lezhë",

VËREJ SE:

Me Vendimin nr. 138, datë 30.12.2015, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe në institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka filluar mbikëqyrjen e përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil. Bazuar në këtë vendim ka vijuar mbikëqyrja edhe në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Lezhë. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 42, datë 28.02.2017, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Drejtoria e Bujqësisë Lezhë, në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Drejtorinë e Bujqësisë Lezhë, i cili është pjesë e këtij

vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.

2. *Njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike si dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, duhet të marrin masa dhe të tregojnë kujdes, që procedurat që kanë lidhje me menaxhimin e shërbimit civil dhe janë kryer në mënyrë elektronike, t’i materializojnë ato edhe në formë shkresore, duke respektuar mënyrën dhe elementët që duhet të përmbajë kopja në letër e dokumentit elektronik, të përcaktuara në ligjin nr. 9880, datë 25.02.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar, ligjin nr.10273, datë 29.04.2010, “Për dokumentin elektronik”, si dhe në udhëzimin nr. 1, datë 31.12.2012, të Ministrisë për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit, “Për vërtetimin e kopjes në letër të dokumentit elektronik nga institucionet publike”.*

Me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil nga nëpunësit përgjegjës, në përputhje me hierarkinë administrative, ashtu dhe nga institucionet e ngarkuara nga ligji për mbikëqyrjen e shërbimit civil, këto kopje duhet të trajtohen në përputhje me kërkesat e ligjit për arkivat dhe normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Në këtë këndvështrim, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore duhet të finalizojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, duke u kujdesur që të merret mendimi i Departamentit të Administratës Publike dhe më tej t’i depozitohet ato në arkivin e institucionit, si dhe pranë Departamentit të Administratës Publike.

3. *Për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në procesin e deklaramentit të statusit të punësimit njësia përgjegjëse (DAP) duhet të veprojë si më poshtë:*
 - *Të anulohet akti administrativ nr. 2149/21, datë 15.08.2014, për deklaramentimin e statusit të punësimit për nëpunësin *****, duke e ndryshuar pozicionimin e tij në raport me shërbimin civil, nga “nëpunës civil”, në “nëpunës civil në periudhë prove”.*
 - *Të anulohet akti administrativ nr. 2149/7, datë 15.08.2014, për deklaramentimin e statusit të punësimit për nëpunësin *****, duke e ndryshuar pozicionimin e tij në raport me shërbimin civil, nga “nëpunës civil”, në “nëpunës civil në periudhë prove”.*
4. *Njësia përgjegjëse dhe njësia e burimeve njerëzore e Drejtorisë së Bujqësisë Lezhë duhet të krijojë mundësinë e ndjekjes së trajnimit të detyrueshëm, nga ana e punonjësit *****; të administrohet rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA) dhe më tej të përfundohet procesi i vlerësimit të rezultateve në punë. Në përfundim të periudhës së provës, të administrohet në dosjen e personelit, së bashku me aktin e vlerësimit të punës, mendimi me shkrim nga nëpunësi civil më i vjetër, udhëzimet e të cilit ka ndjekur nëpunësi gjatë periudhës së provës.*

*Të nxjerrë për nëpunësin ******, vendimin e arsyetuar në përfundim të periudhës së provës për konfirmimin ose jo, si nëpunës civil dhe të njoftohet për realizimin e procesit njësisë përgjegjëse (DAP).*

- 5. Për të rregulluar situatën e ligjshmërisë, në lidhje me momentin e ristrukturimit dhe implementimin e strukturës aktuale, të miratuar me urdhrin nr. 54, datë 22.04.2015, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorive të Bujqësisë”, Komisioni i Ristrukturimit, duhet të rishikojë procedurën e ristrukturimit të Drejtorisë së Bujqësisë Lezhë, duke filluar nga faza e propozimeve drejtuar Njesisë Përgjegjëse (DAP), për transferimet e punonjësve të cilët nuk janë trajtuar nga ana e tyre, sipas orientimeve në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.*

Njësia Përgjegjëse (DAP), pasi të marrë propozimet e Komisionit të Ristrukturimit, duhet të nxjerrë aktet individuale të transferimit për punonjësit e Drejtorisë së Bujqësisë Lezhë.

- 6. Njësia përgjegjëse (DAP), a) në kushtet e ndryshimit që ka sjellë në regjimin juridik të marrëdhënies së punës, Vendimi nr. 877, datë 14.12.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.719, datë 31.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, për nëpunësit e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, i cili, i ka përfshirë ata përsëri në shërbimin civil, si dhe, b) duke marrë parasysht, detyrimin që ka DAP, për të zbatuar nenin 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duhet t’i aplikojë këto ndryshime, sipas orientimeve në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, edhe në rastin e punonjësve ***** dhe ******, të cilët, për shkak të ristrukturimit, janë transferuar nga Drejtoria e Bujqësisë Lezhë në pozicionin e punës, “Specialist”, pranë Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural.*
- 7. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 30 ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.*

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmëruar Nr. 42, datë 28.02.2017, të Komisionerit, me vendimin Nr.148, datë 30.06.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr.42, datë 28.02.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Lezhë”, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të këtij vendimi.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Ilirjan Osmanlliu dhe Joni Marko, me detyrë Specialistë në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të cilët në datën 03.07.2017, u paraqitën pranë institucionit, Drejtoria e Bujqësisë Lezhë.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Lezhë, dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 1346/4 prot., datë 30.06.2017, “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Grupi i punës, gjatë vizitës në subjekt komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetohin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmërues. Takimi me njësinë e burimeve njerëzore, si dhe verifikimi i akteve dhe dokumentacionit shoqërues që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit, është materializuar në procesverbalin e datës 03.07.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe personi i kontaktit i institucionit, Drejtoria e Bujqësisë Lezhë, specialisti për burimet njerëzore.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore të vëna në dispozicion, rezultoi se:

- Në zbatim të pikës 2 të vendimit, Njësia e Burimeve Njerëzore të institucionit, nëpërmjet sistemit HRMIS, kishte printuar përshkrimet e punës në përputhje me ligjin nr.10273, datë 29.04.2010, “*Për dokumentin elektronik*”, si dhe Udhëzimin nr.1, datë 31.12.2012, të Ministrisë për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit të Komunikimit, “*Për vërtetimin e kopjes në letër të dokumentit elektronik nga institucionet publike*”. Nga këqyrja e tyre rezultoi se DAP i kishte kontrolluar dhe miratuar përshkrimet e punës. Procesi ishte përmbyllur me nënshkrimin e tyre nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. Më tej, përshkrimet e punës ishin depozituar në dosjet personale dhe në arkivin e institucionit, sipas rekomandimit të Komisionerit. (*Kopje e përshkrimit të punës dhe vlerësimi i punës është administruar nga grupi i punës*).
- Në pikën 3 të vendimit të Komisionerit, i ishte lënë detyrë njësisë së burimeve njerëzore të institucionit dhe njësisë përgjegjëse DAP, që për të rregulluar situatën e ligjshmërisë, të anulonin aktet nr. 2149/21, datë 15.08.2014, për deklarimin e statusit të punësimit për nëpunësin ***** dhe nr. 2149/7, datë 15.08.2014, për deklarimin e statusit të punësimit për nëpunësin *****, duke e ndryshuar pozicionimin e tyre në raport me shërbimin civil, nga “*nëpunës civil*”, në “*nëpunës civil në periudhë prove*”.

Gjatë verifikimit rezultoi se njësia përgjegjëse dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit e kishin rregulluar situatën e ligjshmërisë për punonjësin ***** përpara daljes së vendimit të Komisionerit (aktet që do të citohen në vijim, nuk janë vënë në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes). Konkretisht, rezulton se punonjësi i sipërcituar ka përfunduar trajnimin e detyrueshëm pranë ASPA-s, në periudhën 30 Mars-10 Prill 2015, duke u vlerësuar me 20 pikë nga 28 të mundshme. Në përfundim të periudhës së provës, me shkresën datë 28.04.2015 (numër protokollit nuk ka), është dhënë mendimi me shkrim nga nëpunësi civil më i vjetër. Sipas përcaktimeve të gërmës a të pikës 3 të nenit 24 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, me aktin administrativ nr.4, datë 28.04.2015, eprori i drejtpërdrejtë ka vendosur konfirmimin e punonjësit si nëpunës civil. Akti i mësipërm i është njoftuar Departamentit të Administratës Publike me shkresën nr.357, datë 28.04.2015, nga ana e titullarit të institucionit.

Ndërkohë, për punonjësin *****, rezulton se njësia përgjegjëse (DAP) dhe njësia e burimeve njerëzore, nuk kanë reaguar në lidhje me rekomandimin e Komisionerit për këtë rast.

- Në zbatim të pikës 4 të vendimit të Komisionerit, me shkresën nr. 968, datë 12.07.2017, të Drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë Lezhë, i është kërkuar Shkollës Shqipare të Administratës Publike, kërkesa për trajnimin e detyrueshëm të punonjësit *****. Zbatimi i kësaj pike të vendimit do të ndiqet më tej nga ana e Komisionerit.
- Në zbatim të pikës 5 të vendimit, njësia e burimeve njerëzore, me shkresën nr.675, datë 23.05.2017, i ka kërkuar Departamentit të Administratës Publike, nxjerrjen e aktit për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit për Drejtorinë e Bujqësisë Lezhë, për shkak të ristrukturimit të institucionit (bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr. 62, datë 12.05.2017, “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 54, datë 22.04.2015, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorive të Bujqësisë”).

Departamenti i Administratës Publike, në përgjigje të shkresës së mësipërme, me shkresën nr.3418/1, datë 13.06.2017, “Mbi caktimin e përfaqësuesve në Komisionin e Ristrukturimit” ka caktuar anëtarët e Komisionit të Ristrukturimit, në përputhje me kërkesat e ligjit për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore dalë në bazë dhe për zbatim të tij. Më tej, Drejtoria e Bujqësisë Lezhë me shkresën nr.801, datë 14.06.2017, ka njoftuar Departamentin e Administratës Publike, për caktimin e përfaqësuesit të Drejtorisë së Bujqësisë Lezhë në Komisionin e Ristrukturimit. Aktualisht, procesi i ristrukturimit nuk është përmbyllur ende.

- Në pikën 6 të vendimit i është lënë detyrë Departamentit të Administratës Publike që të rregullojë ligjshmërinë në rastin e punonjësve ***** dhe *****, të cilët janë transferuar në pozicione jashtë shërbimit civil pranë Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural. Në momentin e verifikimit, rezulton se, ka ndryshuar regjimi juridik i marrëdhënies së punës për nëpunësit e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, duke i përfshirë ata përsëri në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil.

Në rastin konkret, ky ndryshim, është pasqyruar në Vendimin nr. 877, datë 14.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 719, datë 31.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, ku përcaktohet:

- Pika 9: “Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të AZHBR-së rregullohen në bazë të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë të AZHBR-së, rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës”.
- Pika 17: “Për nëpunësit aktualë të AZHBR-së zbatohen dispozitat e nenit 67, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar”.

Për të vënë në zbatim këto ndryshime, sipas pikës 5, të vendimit të sipërcituar, është ngarkuar Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, si dhe Departamenti i Administratës Publike.

Në këtë rast, duhet të mbahet parasysh nga njësia përgjegjëse fakti, që këta nëpunës, e gëzojnë statusin e nëpunësit civil që në momentin e deklarimit të tyre pranë Drejtorisë së Bujqësisë Lezhë, sipas interpretimit që është bërë më lart nga Komisioneri. Ky fakt vlen

për të përcaktuar kohëzgjatjen e punësimit të këtyre punonjësve në pozicionin e punës ku ata kryejnë detyrën, në momentin e deklarimit të statusit të punësimit pranë Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin nr. 42, datë 28.02.2017, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Drejtoria e Bujqësisë Lezhë”*, rezulton se njësia e burimeve njerëzore të institucionit ka bërë përpjekje për zbatimin e këtij vendimi. Aktualisht, pritet reagimi i Departamentit të Administratës Publike dhe njësisë së burimeve njerëzore, në lidhje me:

1. Zbatimin e pikës 3 të vendimit të Komisionerit, për rastin e nëpunësit ***** , në të cilën është kërkuar anulimi i aktit nr. 2149/7, datë 15.08.2014, për deklarimin e statusit të punësimit për këtë nëpunës, duke e ndryshuar pozicionimin e tij në raport me shërbimin civil, nga *“nëpunës civil”*, në *“nëpunës civil në periudhë prove”* dhe përmbushjen e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga periudha e provës, siç është përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Komisionerit.
2. Përmbylljen e procesit të ristrukturimit në përputhje me kërkesat ligjore (pika 5 e vendimit).
3. Zbatimin e rekomandimit të pikës 6 të vendimit të Komisionerit në lidhje me nëpunësit, ***** dhe *****.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Konstatimin e rregullimit të pjesshëm të ligjshmërisë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Drejtorisë së Bujqësisë Lezhë.
2. Verifikimin e mëtejshëm të pikave 3, 4, 5 dhe 6 të dispozitivit të Vendimit nr. 42, datë 28.02.2017, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Drejtoria e Bujqësisë Lezhë”*, për të cilat kërkohet reagimi i Njësisë Përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike dhe njësisë së burimeve njerëzore të institucionit.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Drejtorisë së Bujqësisë Lezhë, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të

Ujërave dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA